



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.111, Datë 27.02.2020

**PËR
PROPOZIMIN PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË
TË KANDIDATIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 27.02.2020, në përfundim të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 109, datë 09.07.2019 njëherazi dhe të procesit të kandidimit në tërësi për këtë pozicion të lirë, bazuar në rezultatet e kësaj procedure përzgjedhjeje për emërim, si dhe mbasi shqyrtoi projektvendimin “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. {...}”,

VËREN

I. HYRJE

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas shkronjës “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të emërimit të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 136, përcakton se një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë përzgjidhet mes juristëve të spikatur, pra nga radhët e jogjyqtarëve, të cilët duhet të plotësojnë disa kushte të përcaktuara shprehimisht në këtë dispozitë (në pika 3 dhe 4), ndërkohë që kritere të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj (fjalja e dytë e pikës 4).

3. Sipas autorizimit kushtetues, kritere të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë janë parashikuar në Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht në nenin 49, i cili referon dhe në dispozita të tjera të këtij ligji.

4. Menjëherë pas krijimit dhe fillimit të funksionimit të tij, më datë 20.12.2018, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimeve ligjore për plotësimin e kuadrit ligjor me aktet nënligjore të autorizuara nga Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, duke vlerësuar si një çështje shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor atë të ngritjes në detyrë, që ishte prioritare dhe sensitive në veçanti për në Gjykatën e Lartë, hartoi dhe miratoi dy nga aktet nënligjore kryesore, miratimi i të cilave do t'i hapte rrugë ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur. Konkretisht, me Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, përfshirë dhe për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur, që përbën dhe fazën e parë të procesit të kandidimit. Ndërsa me Vendimin nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 102/2019), Këshilli plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve nga radhët e juristëve të spikatur, që përbën dhe fazën e dytë të procesit të kandidimit. Po në funksion të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, mbështetur në kategoritë, kriteret, nënkriteret dhe treguesit e vlerësimit profesional dhe etik të kandidatëve, si dhe në të dhënat kryesore të metodologjisë së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit 102/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi më pas dhe Vendimin nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë” (më poshtë referuar si Metodologjia e Vlerësimit dhe Pikëzimit), e cila përmban shpjegime mbi mënyrën se si Këshilli orientohet dhe arsyeton, sipas cilësive dhe të dhënave konkrete të kandidatëve, në raport me secilin prej kriterëve, nënkriterëve dhe treguesve të treguar në Shtojcën e Vendimit 102/2019, për vlerësimin dhe pikëzimin e tyre.

5. Nga interpretimi i dispozitave kushtetues dhe atyre të ligjit të posaçëm, *lex specialis*, rezulton se ligji material ka përçarur qellimin e Kushtetutberesit për transformimin e Gjykatës së Lartë “në një gjykatë karriere përmes vendosjes së kriterëve transparente për emërimin e gjyqtarëve nga të dy kategoritë (gjyqtarë dhe jogjyqtarë/juristë të spikatur)”, për të garantuar një përbërje cilësore jo vetëm nga pikpamja profesionale, por mbi të gjitha edhe të integritetit të figurës. Nisur nga kjo, përmes kuadrit rregullator në tërësi, nëpërmjet kriterëve të vendosura është synuar identifikimi i juristëve të aftë profesionalisht dhe me integritet të lartë moral, pasi në suksesin e vërtetë të një Gjykate të Lartë ndikojnë sa dijet ligjore të gjyqtarëve, aftësia e tyre për të ushtruar që në fillim disiplinë doktrinare, por po aq të rëndësishme janë edhe cilësitë dhe integriteti tyre, në mënyrë që

të kontribuojnë në pavarësinë e gjykatës, për ta bërë atë të pathyeshme ndaj çdo lloj sulmi apo fenomeni negativ që e cënojnë atë.

II. PROCESI I KANDIDIMIT - PROCEDURA E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT

6. Pas plotësimit të kuadrit ligjor që mundësonte realizimin e procedurave ligjore të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në kushtet kur në Gjykatën e Lartë ishin krijuar disa pozicione të lira për shkak të mbarimit të mandatit të disa gjyqtarëve apo shkarkimit nga detyra të disa të tjerëve si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, fillimisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor shpalli hapjen e tre procedurave të ngritjes në detyrë/emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër to edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

7. Konkretisht, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 3/c dhe 5, të nenit 48 dhe nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në pikën 1, të nenit 31, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: “*Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile*”.

8. Brenda afatit dyjavor nga nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të përcaktuar në vendimin si më lart, kanë shprehur interes dhe kanë aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurrimit për pozicionin e shpallur në fushën e të drejtës civile, shtatëmbëdhjetë kandidatë, konkretisht si vijon:

1. Z. {...}; 2. Znj. {...}; 3. Z. {...}; 4. Znj. {...}; 5. Z. {...}; 6. Z. {...}; 7. Z. {...}; 8. Z. {...}; 9. Znj. {...}; 10. Znj. {...}; 11. Znj. {...}; 12. Znj. {...}; 13. Z. {...}; 14. Znj. {...}; 15. Z. {...}; 16. Znj. {...}; 17. Z. {...}.

9. Pas përfundimit të afatit të kandidimit, me Vendimin nr. 142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij 75/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “*Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë*” (pika 1). Po me këtë vendim (pika 2), pas shortit të hedhur, janë caktuar relatorët përkatës për procedurat e verifikimit për secilin kandidat, përfshirë edhe për ata që kanë konkurruar për pozicionin në fushën e të drejtës civile.

10. Procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit kanë përfunduar me vendim të formës së prerë për të gjithë kandidatët, konkretisht si vijon:

1. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë – për shkak të verifikimit të kushtit ndalues të kandidimit, atij të *“riemërimit gjyqtar në Gjykatën e Lartë”*, përcaktuar në nenin 136, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për këtë:
 - a) Me Vendimin nr. 166, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*;
 - b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me Vendimin nr. 222, datë 15.10.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë”*.
2. Znj. {...} është përfunduar procedura e verifikimit, pa vendim përfundimtar, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi. Për këtë:
 - a) Me Vendimin nr. 161, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatës znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për pozicionin e lirë për në Gjykatën e Lartë, të shpallur me ... Vendim nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*;
 - b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.
3. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kushtit të kandidimit, atij të *“mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Për këtë:
 - a) Me Vendimin nr. 170, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*;
 - b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me Vendimin nr. 209, datë 30.09.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë”*.
4. Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të *“nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në

nenin nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

- a) Me Vendimin nr. 320, datë 20.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin e kandidatës jogjytare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;*
- b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatës, me Vendimin nr.19, datë 07.02.2020, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë”.*

5. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kushtit të kandidimit, atij të *“të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*, përcaktuar në nenin 136, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 2, shkronja “b” në lidhje me nenin 2, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

- a) Me Vendimin nr. 162, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;*
- b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me Vendimin nr. 235, datë 31.10.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë së paditesit {...}”.*

6. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kushtit të kandidimit, atij të *“mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

- a) Me Vendimin nr. 159, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;*
- b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me Vendimin nr. 216, datë 09.10.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë për të gjitha kërkimet e saj”.*

7. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kushtit të kandidimit, atij të *“mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

- a) Me Vendimin nr. 158, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;*
- b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me Vendimin nr. 207, datë 25.09.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë”.*

8. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kushtit të kandidimit, atij të *“mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

- a) Me Vendimin nr. 169, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;*
- b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

9. Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kushtit të kandidimit, atij të *“mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

- a) Me Vendimin nr. 163, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit znj. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;*
- b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

10. Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të *“nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në nenin nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

- a) Me Vendimin nr. 284, datë 10.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin e kandidatës jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi*

për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 108 dhe 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

11. Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të *“përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet si avokat, lektor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”*, përcaktuar në nenin nenin 136, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

a) Me Vendimin nr. 283, datë 10.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin e kandidatës jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109 datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;*

b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

12. Znj. {...} është përfunduar procedura e verifikimit pa vendim përfundimtar, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi. Për këtë:

a) Me vendimin nr. 168 datë 11.09.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatës znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për pozicionin e lirë për në Gjykatën e Lartë, të shpallur me ... Vendimin nr. 109 datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

13. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kushtit të kandidimit, atij të *“mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

a) Me Vendimin nr. 160, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;*

b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me Vendimin nr. 221, datë 15.10.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë”.*

14. Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kushtit të kandidimit, atij të *“mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:
- a) Me Vendimin nr. 164, datë 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit znj. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*;
 - b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.
15. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të *“nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në nenin nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:
- a) Me Vendimin nr. 228, datë 22.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*;
 - b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me Vendimin nr. 258, datë 17.12.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë”*.
16. Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të *“moskalimit të procesit të verifikimit të pasurisë”*, përcaktuar në nenin nenin 49, pika 5 në lidhje me nenin 32 pika 4 shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:
- a) Me Vendimin nr. 41, datë 23.01.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Skualifikimin e kandidates jogjqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me ... Vendimin nr. 108 dhe 109 datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*;
 - b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me Vendimin e datës 21.02.2020, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë”*.
17. Z. {...} është kualifikuar në procedurën e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit. Për këtë:

- a) Me Vendimin nr. 255, datë 12.11.2019, Këshilli I Lartë Gjyqësor ka vendosur:
“Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;
- b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

11. Nga shtatëmbëdhjetë kandidatë, nga radhët e juristëve të spikatur, që kanë konkuruar për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vetëm njëri prej tyre, konkretisht z. {...}, është kualifikuar për të vijuar procedurat e mëtejshme të kandidimit, atë të përzgjedhjes për emërim.

III. PLOTËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT NGA KANDIDATI I KUALIFIKUAR

12. Referuar Vendimit nr. 255, datë 12.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka verifikuar plotësimin e kushtet dhe kriteret e kandidimit nga kandidati z. {...}.

13. Kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 136, pikat 3 dhe 4. Në këto pika të kësaj dispozite përcaktohet se:

“3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.

4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”.

14. Po ashtu, kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, janë përcaktuar edhe në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 49 (“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”), pikat 1 dhe 2, shkronja “b”. Në këto pika të kësaj dispozite përcaktohet se:

“1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

15. Konkretisht, për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi i këtyre kushteve të kandidimit/emërimit:

a) qenia jurist - Për këtë kusht kandidimi/emërimi është administruar dokumenti *Diplomë nr. {...}, me nr. regjistri {...}, lëshuar më datë {...}*, nga Univerisiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidati {...}, në periudhën 1991 - 1995, ka kryer kursin e plotë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në Degën “Drejtësi” dhe me vendim të komisionit shtetëror të datës 11.07.1995 i është dhënë titulli “Jurist”. Bashkëngjitur Diplomës është dhe dokumenti (i njëzuar me origjinalin) “Lista e Rezultateve të Provimeve”, lëshuar më datë 11.07.1995, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

b) përvoja profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës - Për këtë kusht kandidimi/emërimi është administruar dokumenti “Librezë Pune”. Po ashtu, referuar subjekteve punëdhënës sipas dokumentit “Librezë Pune”, është kërkuar dhe është marrë informacion për të dhënat e punësimit të kandidatit: me Shkresën nr. 4028/1 prot., datë 09.08.2019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; me Shkresën e datës 31.10.2019, Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”; me Shkresën nr. 368 prot., datë 17.07.2019, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë; me Shkresën nr. 700/1 prot., datë 15.08.2019, Shkolla e Magjistraturës; me Shkresën nr. 425/1 prot., datë 30.08.2019, Albanian University; me Vërtetim datë 18.07.2019, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu, është kërkuar dhe është marrë informacion nga: nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, konkretisht përmes Shkresës nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Shkresës nr. 5744/1 prot., datë 09.08.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shkresës nr. 8468 prot., datë 17.09.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë. Sipas të dhënave të grumbulluara, deri në momentin e kandidimit, ka rezultuar që kandidati të ketë përvojë profesionale përmbi 23 vjet, si avokat (10 vjet), si lektor i të drejtës me kohë të plotë (23 vjet e 2 muaj) dhe si jurist i nivelit të lartë në administratën publike (4 muaj);

c) pasja gradë shkencore në drejtësi - Për këtë kusht kandidimi/emërimi është administruar dokumenti *Diplomë Doktorate nr. {...}, me nr. Regjistri {...} lëshuar me datë {...}* nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidati {...}, ka marrë gradën shkencore “Doktor”. Po ashtu, është kërkuar dhe është marrë informacion nga ministria përgjegjëse për arsimin, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se: “...5. Grada shkencore “Doktor” në “E drejtë

Civile” e fituar nga z. {...} figuron e regjistruar ne regjistrin e KVTA-së për Gradën Shkencore: “Doktor” me numër rendor: 81, Universiteti i Tiranës, Nr. Vendimi: {...}, datë {...}. ... Të gjitha gradat shkencore të listuara më sipër, përveç gradës shkencore të fituar nga ..., i përkasin fushës së drejtësisë”;

ç) mbajtja e funksioneve politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit - Për këtë kusht kandidimi/emërimi është administruar një deklaratë me shkrim e datës 30.07.2019, nëpërmjet të cilës kandidati, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit*”. Po ashtu, janë mbajtur parasysh edhe të dhënat e informacioneve në lidhje me punësimin e kandidatit. Nga informacionet e marra nuk identifikohet ndonjë e dhënë sipas të cilës të verifikohet që kandidati të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit;

d) mbajtja e pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit - Për këtë kusht kandidimi/emërimi është administruar një deklaratë me shkrim e datës 30.07.2019, nëpërmjet të cilës kandidati, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*nuk kam mbajtur ... pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit*”. Po ashtu, është kërkuar dhe është marrë informacion nga gjykata e regjistrit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Shkresën nr. 847/4 prot., datë 28.10.2019. Sipas të dhënave të grumbulluara, nuk ka rezultuar që kandidati të ketë qënë pjesë e organeve drejtuese të partive politike.

16. Kriteret e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, që përcaktohen nga ligji si kriteret zgjedhshmërie, sipas shkronjës “a”, pika 1, të nenit 66¹ (titulluar “Pazgjedhshmëria dhe papajtueshmëria”), të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohen në këtë ligj (Ligjin 96/2016), konkretisht në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”.

17. Në nenin 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f", të nenit 28, të këtij ligji; ... ”.

¹ “1. Statusi i magistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e pazgjedhshmërisë si vijon: a) kur magistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara, sipas nenit 28 të këtij ligji; ... ”

18. Ndërsa në nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar;

b) është shtetas shqiptar;

...;

d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë;

dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;

...;

ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

19. Konkretisht, për kandidatin z.{...} është verifikuar plotësimi i këtyre kriterëve të kandidimit/emërimit:

a) zotësia e plotë për të vepruar - Për këtë kriter kandidimi/emërimi është mbajtur në konsideratë se, referuar moshës së kandidatit, ai ka fituar zotësinë juridike, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa nuk rezulton që ajo t’i jetë hequr apo kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kështu, është kërkuar dhe është marrë informacion nga gjykata e vendbanimit të kandidatit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Shkresën nr. 8407/2 prot., datë 25.10.2019, si dhe nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, me Shkresën nr. 2659 prot., datë 30.10.2019. Sipas të dhënave të grumbulluara, kandidati nuk figuron në listën e personave të cilëve iu është hequr zotësia për të vepruar;

b) shtetësia shqiptare - Për këtë kriter kandidimi/emërimi është administruar dokumenti “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 25.03.2019, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, konkretisht “shqiptare”. Po ashtu, është administruar dhe dokumenti certifikata personale lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake nr. 10 Tiranë, më datë 31.07.2019, sipas të cilës kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare. Ndërkohë nuk është gjetur ndonjë e dhënë për heqjen kandidatit të shtetësisë shqiptare;

c) gjendja gjyqësore - Për këtë kriter kandidimi/emërimi është administruar dokumenti “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”, me nr. 7 prot., datë 18.07.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit kandidati figuron i padënuar penalisht. Po ashtu, është

kërkuar dhe është marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore), me Shkresën nr. V-2595/1 prot., datë 09.08.2019, sipas të cilës, ndër të tjera, konfirmohet se nga verifikimi në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Gjyqësore, kandidati rezulton i padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

ç) disiplina në punë - Për këtë kriter kandidimi/emërimi është administruar një deklaratë me shkrim e datës 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, kandidati ka deklaruar se “*gjatë karrierës time profesionale nuk jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk kam marrë dhe as nuk kam asnjë masë disiplinore*”. Po ashtu, është administruar dhe dokumenti “Librezë Pune”, në të cilën, në rubrikën “Shkaku i largimit nga puna”, nuk pasqyrohet në asnjë rast që kandidati të jetë larguar nga puna për shkaqe disiplinore. Nga ana tjetër, është kërkuar dhe është marrë informacion nga të gjithë subjektet shtetërore dhe private, ku kandidati ka punuar dhe punon aktualisht, sipas shkresave të pasqyruara dhe në shkronjën “b”, pika 12, e këtij vendimi. Sipas të dhënave të grumbulluara, nuk rezulton që kandidati të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore apo që ndaj tij të jetë marrë dhe të ketë masë disiplinore në fuqi;

d) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990 - Për këtë kriter kandidimi/emërimi është administruar një deklaratë me shkrim e datës 22.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, kandidati ka deklaruar se “*nuk kam qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*”. Po ashtu, kandidati i është kërkuar dhe ai ka dorëzuar të plotësuar formularin e aplikimit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Me tej, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit i është kërkuar dhe ai ka kryer verifikimin përkatës, rezultatet e të cilit janë dërguar me Shkresën nr. 1177/4 prot., datë 12.09.2019, bashkëlidhur të cilit Vendimi nr. 565 datë 10.09.2019, me të cilin është vendosur: “*Të informojë institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 4228 prot., datë 27.08.2019, “Kërkesë për verifikim”, të pastërtisë së figurës, përpara emërimit të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, se nga verifikimet e kryera deri tani për zotin {...} nuk rezulton : a) të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;*

dh) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete - Për këtë kriter kandidimi/emërimi është administruar një deklaratë me shkrim e datës 22.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, kandidati ka deklaruar se “*nuk kam qenë dhe nuk jam bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete*”. Po ashtu, në kuadër të

verifikimit të figurës së kandidatit, është kërkuar dhe është marrë informacion nga organet ligjzbatuese sipas pikës 2, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas të dhënave të grumbulluara, nuk rezulton që kandidati të këtë qenë apo të jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

IV. PROCEDURA E KANDIDIMIT - PROCEDURA E PËRZGJEDHJES PËR EMËRIM

20. Bazuar në pikën 1, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit 102/2019, menjëherë pas kualifikimit të kandidatit të parë për pozicionin në fushën të drejtës civile, me Vendimin nr. 261, datë 13.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: *“Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*. (pika 1) Po me këtë vendim (pika 2), pas shortit të hedhur, është caktuar relatori përkatës për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve për pozicionin në fushën e të drejtës civile.

21. Në kushtet kur vetëm një prej kandidatëve konkurrent është kualifikuar në fazën e parë të procesit të kandidimit, pra atë të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, procedura e përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), pra faza e dytë e procesit të kandidimit, ka vijuar vetëm për këtë kandidat, konkretisht z. {...}.

22. Në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Vendimit 102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.102, datë 26.02.2020, miratoi vlerësimin dhe pikëzimin paraprak për kandidatin z. {...}. Sipas këtij vendimi, kandidati është vlerësuar dhe pikëzuar paraprakisht në total me 84 pikë, nga 100 pikë të mundshme.

23. Në vijim të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, pas vlerësimit dhe pikëzimit paraprak, edhe pse z. {...} ishte kandidati i vetëm në procedurën e përzgjedhjes, në zbatim të pikës 7, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sikundër dhe Vendimit të tij 102/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi me kandidatin një intervistë, në një seancë publike, më datë 27.02.2020.

24. Pas intervistës me kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vijoi shqyrtimin dhe vendosi në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit për secilën kategori të meritave, kriter, nënkriter dhe tregues, të përcaktuar në pikën 6, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin

e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të detajuar më tej në Vendimin 102/2019, plotësuar me shpjegimet përkatëse të të dhënave metodologjike me Metodologjinë e Vlerësimit dhe Pikëzimit. Kështu, me Vendimin nr. 105, datë 27.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor e vlerësoi përfundimisht kandidatin z. {...} me 84 pikë, nga 100 pikët e mundshme.

25. Po kështu, në vijim të procedurës së përzgjedhjes për emërim, mbështetur në pikën 8, të nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 10, Seksioni D, Kreu VI, të Vendimit 102/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 109, datë 27.02.2020, vendosi: *“Miratimin e renditjes së kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. Z. {...}”*.

V. KONKLUZIONE

26. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati z. {...}, në rrethanat kur është verifikuar të plotësojë kushtet dhe kriteret e kandidimit për emërim në Gjykatën e Lartë, ndërsa është vlerësuar pozitivisht në një nivel domethënës dhe i renditur i pari sipas meritave profesionale, etike, organizative dhe menaxheriale, duhet t’i propozohet Presidentit të Republikës për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në shkronjën “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 2, të nenit 85, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 97 dhe shkronjën “c”, pika 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9 dhe 10, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikat 11 dhe 12, Seksioni D, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. T’i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR